

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shpenzime pastrimi, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera për zyra”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- 90919200-4 - Shërbime pastrimi zyre

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,500,000.00 (një milion e pesëqind mijë) Lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SHA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: u arsyetua që OE duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe Sigurimin e Ofertës, në ditën e hapjes së ofertës sipas Shtojcave të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe nenin 82 të LPP (të ndryshuar), nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro minimale vjetore, në një vlerë të paktën prej 600,000.00 (gjashtëqind mijë) Lekë pa TVSH, gjatë tre viteve të fundit financiare.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse OE ofertues arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarates të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP të ndryshuar, si dhe nenin 43 dhe neni 55, pika 4, paragrafi 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të provojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me termat e referencës të kërkuara. OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe për këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros duhet të jetë 40% e fondit limit, përkatësisht në vlerën 600,000.00 (gjashtëqind mijë) Lekë pa TVSH, gjatë tre viteve të fundit financiare.

2.3 Përsa i përket aftësive teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, u arsyetua që ofertuesi duhet të tregojë se i zotëron këto aftësi dhe është në gjendje ta kryej kontratën objekt prokurimi. Në lidhje me këtë u arsyetua dhe argumentua se Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 300,000.00 (treqind mijë) Lekë pa TVSH.

- Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohe vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave/shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenit 41 pika 3 dhe neni 55 pika 4/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal në mënyrë që AK të ketë sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar vjetor i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 5 punonjës.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar, shoqëruar me listëpagesat përkatëse E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Shenim: Në plotësimin e “Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit”, në pikën B “Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohe)”, OE ofertues

duhet të shënojnë në mënyrë të saktë, kualifikimet përkatëse të punonjësve. Këto deklarime do të shqyrtohen kur OE ofertues do të paraqesë dokumentet origjinale ose kopje të noterizuara për punonjësit, para shpalljes fituese të ofertës. Keqinformimi dhe dorëzimi i dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, sanksionohet nga pika 1/ e nenit 78 “Përjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa për stafin e nevojshëm për kryerjen e shërbimit objekt procedure prokurimi bazohet në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe pikën 4/c, të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky numër punonjësish konsiderohet minimal për shërbimin e kërkuar objekt kontrate.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatën përkatëse të vlefshme ISO, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, që ka lidhje me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, nenit 44, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në bazë Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohet se këto Çertifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate.

- **Standardi i cilësisë ISO 9001:** është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

2.3.4 *Për detergjentët dhe produktet e kërkuara si më poshtë duhet të paraqitet Skeda Teknike e tyre:*

1	Solucion zbardhues dhe dezinfektues WC	litër
---	--	-------

2	Solucion larës pllakash	litër
3	Solucion për larje xhamash	copë
4	Solucion/ Detergjent për pastrim mobiliesh	copë
5	Sapun i lëngshëm për larje duarsh	litër
6	Solucion me përmbajtje klori për larje dyshemeje	litër

Argumentimi: Materialet e kërkuara në këtë procedurë prokurimi duhet të jenë të një cilësie të lartë, në mënyrë që të garantohet kujdesi i nevojshëm për ambientet e ALPEX SHA. Ky kriter bazohet në nenin 41, pika 4/ç dhe nenin 40, pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qira makineritë, sipas Termave të Referencës, të nevojshme për kryerjen e shërbimit të kërkuar mjetet si vijon:*

- *Makineri larëse tharëse të dyshemesë – 1 copë*
- *Makineri thithese pluhrash dhe lëngjesh – 1 copë*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë gjithë dokumentacionin e rregullt:

- Për makinëritë– fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimit, katalogët teknikë, si dhe foto. Në rastin kur është me qira, duhet të disponojë dokumentacionin e sipërcituar dhe kontratën e qirasë.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kriteri i sipërcituar është vendosur në përputhje me volumin dhe natyrën e shërbimit objekt prokurimi. Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, dhe pikën 4/ç, të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.6 *Në funksion të plotësimit të Shtojces 10 “Formulari Përmbledhes i Vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76, pika 1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ALPEX SHA ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atësi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe Termat e Referencës, janë hartuar nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, duke përlllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Termat e Referencës janë hartuar në përputhje me natyrën dhe specifikat e kontratës për ofrimin e shërbimit të pastrimit të ambienteve të institucionit për një periudhë 12-mujore. Kërkesat teknike janë përcaktuar duke pasur parasysh nevojën për garantimin e higjienës, pastërtisë dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të ambienteve të punës, me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për punonjësit.

Termat e Referencës janë hartuar në mënyrë të qartë, të plotë dhe jodiskriminuese, duke mundësuar pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë në treg dhe duke garantuar konkurrencë të ndershme. Frekuenca e shërbimeve, kërkesat për personelin, pajisjet dhe materialet e pastrimit janë përcaktuar në funksion të sipërfaqeve dhe nevojave reale të institucionit, duke synuar realizimin e shërbimit me cilësi dhe eficiencë gjatë gjithë periudhës së kontratës.



Kërkesat e përcaktuara janë proporcionale me objektin e kontratës dhe të nevojshme për realizimin e saj, pa krijuar kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë.